



Republika e Kosovës/Republike Kosovo/Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës
Institucija Ombudsmena Republike Kosovo
Ombudsman institution of Republic of Kosovo

2021 - 2025


STRATEGJIA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT 2021 - 2025

Ë

PLANI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT 2021 - 2023



EU Support to Ombudsman Institution in Kosovo project is implemented
by a Consortium led by Hulla and Co. Human Dynamics GmbH & Co.



Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, 18.03.2021

Avokati i Popullit,

në mbështetje të neneve 132 dhe 133 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1, 3, paragrafi 3 dhe nenit 35 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, si dhe nenit 15 dhe nenit 16 të Rregullores së Punës me Nr. 02/2016 në Institucionin e Avokatit të Popullit, merr:

V E N D I M

1. Miratohet **Strategjia e Institucionit të Avokatit të Popullit 2021 – 2025**, sipas dokumentit të bashkëngjitur të këtij vendimi.
2. Miratohet **Plani i zbatimit të Strategjisë së Institucionit të Avokatit të Popullit 2021 – 2023**, sipas dokumentit të bashkëngjitur të këtij vendimi.
3. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë do të bëhet nga një Strukturë koordinuese për monitorim dhe zbatim të Strategjisë, që do të caktohet me vendim të Avokatit të Popullit;
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Naim Qelaj
Avokati i Popullit

Tabela e Përmbajtjes

06
Hyrje

08
Përmbledhje ekzekutive

09
Qëllimet strategjike

11
Metodologjia

12
Parimet, vizioni dhe misioni

14
Analiza e çështjeve kryesore

40
Monitorimi dhe raportimi
për Strategjinë



Repubika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit/Instuticija Ombudsmana/Ombudsperson Institution

**STRATEGJIA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT
TË POPULLIT**

2021-2025

Hyrje

Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë është institucion i pavarur kushtetues i Republikës së Kosovës. Institucioni i Avokatit të Popullit (më tutje: IAP) ka vazhduar ta zbatojë suksesshëm mandatin, ta përmirësojë gradualisht performancën e tij dhe ndikimin në punën e institucioneve të tjera në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë. IAP-ja mbetet institucioni më i besuar nga qytetarët dhe i perceptuar nga qytetarët si institucioni më autonom sa u përket ndërhyrjeve politike. Megjithatë, duke marrë parasysh situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë, ekziston hapësirë dhe nevojë e madhe për shtimin e përpjekjeve për promovim, mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe parandalim të shkeljeve nga institucionet e tjera.

Për ta avancuar zbatimin e mandatit të vet, IAP-ja, përmes Strategjisë së saj 2021-2025, ka përcaktuar vizionin, misionin, objektivat strategjike dhe ato specifike dhe veprimet që synojnë ta udhëheqin punën afatmesme të IAP-së në zbatimin e parimeve dhe dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; të Ligjit për Avokatin e Popullit; të standardeve ndërkombëtare dhe të legjislacionin tjetër në fuqi në Kosovë. Strategjia është mjet për prioritizim dhe përqendrim të përpjekjeve të IAP-së në fusha dhe segmente në të cilat konsiderohet se ka nevojë më tepër me qëllim të zbatimit të obligimeve kushtetuese dhe ligjore.

Prandaj qëllimi i Strategjisë së IAP-së është të kontribuojnë në rritjen e ndikimit të punës së Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale si dhe në parandalimin e shkeljeve nga ana e institucioneve publike. Përveç kësaj, Strategjia synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit të qytetarëve për mandatin, rolin dhe përgjegjësitë, sigurimin e transparencës, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të punës, si dhe rritjen e kapaciteteve profesionale dhe administrative të tij. Gjithashtu IAP-ja përmes kësaj Strategjie synon t'i promovojë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm që lidhen me rolin dhe përgjegjësitë e tij dhe të ndërtojë një sistem të monitorimit të tyre. Arritja e qëllimit të tillë mund të bëhet vetëm përmes një mekanizmi të planifikimit afatmesëm të Avokatit të Popullit, më anë të të cilit përcaktohen objektiva, masa dhe aktivitete të qarta si dhe sistem të mirëfilltë të monitorimit të zbatimit të tij.

Përcaktimi i objektivave, treguesve dhe caqeve që synohen të arrihen përmes kësaj Strategjie ka marrë parasysh një numër të faktorëve dhe rrethanave që determinojnë funksionimin e IAP-së. Obligimet kushtetuese dhe ligjore për IAP-në janë faktori kryesor dhe udhëheqës për përcaktimin e orientimeve strategjike, të cilat do ta mundësojnë zbatimin sa më të mirë të tyre. Mënyra e ndërveprimit me institucionet e tjera dhe sfidat që janë paraqitur, sidomos nga veprimi apo mosveprimi i tyre ndaj rekomandimeve të IAP-së, krijon bazë për përqendrim më të madh të IAP-së në aktivitetet të cilat mundësojnë tejkalimin apo zvogëlimin e këtyre sfidave. Në anën tjetër, mundësitë sa i përket pozicionit të IAP-së në kontekstin e përgjithshëm institucional, kapacitetet ekzistuese, si ato financiare, ashtu edhe profesionale, janë rrethana të cilat ose mundësojnë apo kushtëzojnë planifikimin e masave të caktuara në planin e ardhshëm afatmesëm. Mbështetja që i ofrohet IAP-së qoftë nga Bashkimi Evropian apo nga mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë, përmes formave të ndryshme, e në veçanti përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë teknike dhe profesionale, janë faktorë shumë të rëndësishëm që do ta mundësojnë zbatimin e suksesshëm të Strategjisë. Transferimi i ekspertizës dhe rritja e pronësisë së institucionit të IAP-së do t'i sigurojë atij arritjen e vizionit dhe qëllimeve të Strategjisë.

Hartimit të Strategjisë i ka paraprirë një vlerësim i detajuar, gjetjet e tij dhe sfidat e hasura e të prezantuara nga Raporti për zbatimin e Strategjisë së Institucionit të IAP-së 2017-2019, i zhvilluar gjatë muajit gusht dhe shtator 2019. Përveç kësaj, një vlerësim i nevojave të trajnimeve për institucionin e IAP-së dhe plani i trajnimeve kanë qenë baza për planifikim strategjik në fushën e ngritjes së kapaciteteve të IAP-së.

Arsyeja e kryesore për zhvillimin dhe miratimin e Strategjisë mbetet zbatimi i saj. Prandaj Strategjia e IAP-së 2021-2025, përveç si një dokument planifikues, shërben edhe si dokument me anë të të cilit duhet të vlerësohet performanca e institucionit. Strategjia, plani i saj i zbatimit 2021-2023 dhe procesi i saj i vazhdueshëm i monitorimit dhe raportimit duhet të shërbejnë si bazë për përmirësimin e procesit të vendimmarrjes strategjike të IAP-së për pesë vjetët e ardhshme.

Përmbledhje ekzekutive

Strategjia për Avokatin e Popullit 2021-2025, përfshinë qëllimet strategjike dhe objektivat specifike, të cilat synohen të arrihen gjatë periudhës 5-vjeçare, ndërsa progresi apo arritja e të cilave matet përmes treguesve dhe caqeve të përcaktuara në Strategji. Strategjia zbatohet përmes planit trevjeçar të zbatimit, i cili është pjesë përbërëse e Strategjisë.

Strategjia, përveç pjesës hyrëse, metodologjisë së punës, bazës ligjore për funksionimin e IAP-së, përmban një përmbledhje të analizës së situatës aktuale, sfidave dhe çështjeve që synohen për t'u adresuar.

Pjesa qendrore e Strategjisë përbëhet nga kapitulli i cili përmban:



Qëllimet e Përgjithshme



Objektivat Specifike



Treguesit



Caqet

Qëllimet strategjike

Strategjia për IAP-në përmban katër qëllimet strategjike, ndërsa secila prej tyre përmban një numër të objektivave specifike. Qëllimet strategjike dhe objektivat specifike të Strategjisë janë si në vijim:

01

Mbrojtja dhe mbikëqyrja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përmes ndikimit të shtuar të Institucionit të Avokatit të Popullit në përmbushjen e mandatit të tij

- Vetëdijesimi i publikut për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut
- Promovimi dhe edukimi për të drejtat e njeriut tek institucionet përgjegjëse për zbatimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore në vend
- Rritja e bashkëpunimit të IAP-së me institucionet e tjera dhe organizata joqeveritare
- Avancimi i komunikimit të vazhdueshëm dhe ndërgjegjësimit për rolin dhe rëndësinë e IAP-së

- Mbrojtja dhe mbikëqyrja e respektimit të të drejtave të njeriut, me fokus edhe në rastet sistematike me interes të përgjithshëm
- Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit në shqyrtimin e ankesave dhe rasteve ex-officio
- Rritja e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të IAP-së
- Mbikëqyrja e legjislacionit në raport me të drejtat dhe liritë e njeriut në Kosovë

02

Promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe roli i IAP-së

- Zhvillimi i programeve vetëdijesuese për promovimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

- Zhvillimi i një sistemi për gjenerimin e të dhënave në raport me indikatorët e OZhQ-së mbi mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga IAP-ja.

- Avancimi i kapaciteteve të stafit të IAP-së për promovimin e OZhQ-së, adresimin e tyre dhe ndërlidhjen e tyre me të drejtat e njeriut

- Bashkëpunimi ndërkombëtar në ndërtimin e kapaciteteve reciproke, shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira me vendet rajonale drejt arritjes së progresit në promovimin dhe adresimin e OZhQ-së

03

Promovimi i Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ)

04

Zhvillimi i metejmë i kapaciteteve institucionale dhe i burimeve njerëzore të IAP-së

- Ofrimi i vazhdueshëm i mundësive për mësim dhe zhvillim profesional për stafin e IAP-së

- Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar për stafin përmes programeve të shkëmbimit

- Forcimi i kapaciteteve institucionale, të administratës dhe të menaxhimit të brendshëm të IAP-së, përfshirë përmes rishikimit funksional dhe të akteve të brendshme normative

Strategjia gjithashtu përmban një kapitull, përmes të cilit udhëzohet ndërtimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit të saj, përfshirë mekanizmat institucionalë që duhet të themelohen për monitorim dhe raportim, përgjegjësitë për raportim dhe zbatim, periudhat e raportimit etj. Ajo parasheh gjithashtu nevojën për vlerësimin afatmesëm të zbatimit të Strategjisë dhe vazhdimin/rishikimin e planit të veprimit pas periudhës trivjeçare. Përveç kësaj, Strategjia parasheh nevojën e një vlerësimi të rreziqeve si dhe hartimin e planit të menaxhimit të tyre pas miratimit të saj.

Vlerësimi i ndikimit financiar të Strategjisë bëhet përmes kostos së secilit aktivitet të përcaktuar në planin e zbatimit të Strategjisë. Një përmbledhje e vlerësimit të ndikimit financiar dhe burimeve të financimit të saj është paraqitur në një seksion të ndarë në pjesën e fundit të Strategjisë.

Metodologjia

Strategjia për Institucionin e Avokatit të Popullit 2021-2025 është hartuar kryesisht mbi bazën e gjetjeve dhe rekomandimeve të nxjerra nga Raporti për zbatimin e Strategjisë dhe Planit zhvillimor të Institucionit të Avokatit të Popullit 2017-2019, i hartuar gjatë muajit gusht-shtator 2019. Rishikimi i tekstit të Strategjisë është bërë së fundmi në nëntor-dhjetor 2020 për të reflektuar zhvillimet e fundit, visionin dhe synimet e Avokatit të ri të Popullit i emëruar në tetor 2020 nga Kuvendi. Orientimet dhe synimet strategjike të Strategjisë janë bazuar në visionin e Avokatit të Popullit për përmirësimin e funksionimit të IAP-së, rezultateve të diskutimeve nga takimet individuale me zëvendësit e tij, menaxhmentin dhe stafin e IAP-së.

Koordinimi i punës në hartimin e Strategjisë është bërë nga Grupi Punues i themeluar me vendimin e Avokatit të Popullit, i datës 18 shtator 2019, dhe i rishikuar në nëntor 2020. Hartimi i Strategjisë dhe i planit të zbatimit është ndihmuar nga eksperti i jashtëm, i mbështetur nga Projekti i Bashkimit Evropian "Mbështetje Institucionit të Avokatit të Popullit". Projekti gjithashtu ka mbështetur IAP-në me organizimin e punëtorive dhe aktiviteteve të tjera, me qëllim të hartimit dhe diskutimin e strategjisë dhe të planit të zbatimit.

Procesi i hartimit të Strategjisë ka kaluar në disa faza kryesore:

Faza e analizës dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë 2017-2019, përmes së cilës është bërë vlerësimi i situatës aktuale si dhe identifikimi i sfidave dhe nevojave të IAP-së, e cila është zhvilluar gjatë muajit gusht dhe pjesës së parë të muajit shtator 2019. Kjo fazë ka rezultuar me finalizimin e Raportit për zbatimin e Strategjisë dhe Planit zhvillimor të Institucionit të Avokatit të Popullit 2017-2019 dhe prezantimit dhe diskutimit të tij në punëtorinë e organizuar më 17 shtator me gjithë stafin menaxhues të IAP-së.

Faza e hartimit të Strategjisë: Mbi bazën e gjetjeve dhe rekomandimeve të nxjerra nga Raporti për zbatimin e Strategjisë dhe Planit zhvillimor të Institucionit të Avokatit të Popullit 2017-2019 janë nxjerrë qëllimet e reja strategjike, objektivat specifike, treguesit dhe caqet. Përveç kësaj, orientimet dhe synimet strategjike të Strategjisë janë bazuar në vizionin e Avokatit të Popullit për përmirësimin e funksionimit të tij, rezultateve të diskutimeve nga takimet individuale me zëvendësit e Avokatit të Popullit si dhe menaxhmentin e IAP-së gjatë pjesës së dytë të shtatorit dhe pjesës së parë të muajit tetor 2019. Freskimi i informatave për gjendjen aktuale dhe zhvillimet e fundit janë reflektuar në Strategji gjatë muajve nëntor-dhjetor 2020. Gjithashtu, për të reflektuar vizionin e Avokatit të ri të Popullit, me sugjerimin e tij dhe të stafit të IAP-së, gjatë procesit të rishikimit të draft Strategjisë është bërë modifikimi i qëllimeve strategjike, objektivave specifike, indikatorëve dhe planit të zbatimit. Drafti i fundit i Strategjisë është diskutuar dhe finalizuar në një punëtori triditore, e mbajtur më 21-23 janar 2021.

Faza e hartimit të Planit të Veprimit: Hartimi i Strategjisë së IAP-së është pasuar nga hartimi i planit për zbatimin e saj. Grupi Punues dhe drejtorët e departamenteve të IAP-së që nuk janë pjesë e grupit, janë ftuar të marrin pjesë në punëtorinë njëditore, e cila është mbajtur më 27 nëntor 2019. Draft Strategjia dhe plani i zbatimit të saj janë diskutuar në këtë punëtori. Grupi Punues në punëtori me mbështjen e ekspertit të jashtëm të mbështetur nga projekti i Komisionit Evropian kanë finalizuar draftin e planit të zbatimit të Strategjisë. Gjithashtu drafti i planit të zbatimit të Strategjisë është rishikuar pas rishikimit të Strategjisë në fund të vitit 2020 dhe në janar 2021. Finalizimi i draft planit për vitet 2021-2023 është bërë në punëtorinë e datës 21-23 janar 2021 të organizuar nga IAP-ja, ndërsa ofrimi i mbështetjes profesionale është bërë nga eksperti i jashtëm i angazhuar nga Projekti i BE-së, mbështetje për IAP-në.

Parimet, Vizioni dhe Misioni

Parimet bazë të veprimtarisë së Avokatit të Popullit janë:
Avokati i Popullit është institucion i pavarur që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.

Institucioni i Avokatit të Popullit shërben si mekanizëm ligjor efektiv, efikas dhe i pavarur, që mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.



Deklarata e Vizionit



Deklarata e Misionit

Misioni i IAP-së si mekanizëm ligjor është mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve të tjera, të cilat ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës nëpërmjet: pranimit dhe hetimit të ankesave për shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut nga autoritetet publike në Kosovë, parandalimi i torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, mbrojtja nga diskriminimi dhe barazia gjinore, për t'i kontribuar qeverisjes së mirëtransparente dhe llogaridhënies së administratës publike para qytetarëve të Kosovës dhe forcimit të sundimit të ligjit në epiqendër të të cilit qëndrojnë mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut në Kosovë.

Analiza e çështjeve kryesore

Korniza
ligjore

01

Mandati i
Institucionit të
Avokatit të Popullit

02

Përmbledhje e
situatës aktuale dhe
e sfidave kryesore

03

01

Institucioni i Avokatit të Popullit është themeluar më 30 qershor 2000 me Rregulloren e UNMIK-ut mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë 2000/38. Deri në dhjetor të vitit 2005, institucioni është udhëhequr nga një ombudsperson ndërkombëtar. Pas largimit të ombudspersonit ndërkombëtar, deri në zgjedhjen e Avokatit të Popullit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, institucioni është udhëhequr nga ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit. Në vitin 2008, pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në vitin 2009 Kuvendi emëroi Avokatin e ri të Popullit. Funkcioni i Avokatit të Popullit sipas ligjit për Avokatin e Popullit ka për qëllim krijimin e një mekanizmi ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Përveç kësaj, Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Parandalues Kombëtar kundër Torturës dhe Trajtimeve dhe Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Poshtëruese. Avokati i Popullit gjithashtu shërben si një mekanizëm i barazisë për promovimin, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë pa diskriminim në baza të njohura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit, IAP-ja përbëhet nga: Avokati i Popullit, pesë (5) zëvendësit e Avokatit të Popullit dhe stafi i IAP-së.

Në maj të vitit 2015, si pako e ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, u miratuan ligjet në vijim:

- **Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit .**
- **Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi .**
- **Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore .**

Këto ligje, të njohura si "Paketa e legjislacionit për të Drejtat e Njeriut", i dhanë mandat të ri dhe kompetenca shtesë Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës. Ligji për Avokatin e Popullit përfshin shumicën e rekomandimeve të komunikuara në raportin e përbashkët të BE-së dhe Këshillit të Evropës. Aktualisht Kosova ka një kuadër ligjor dhe institucional që është në gjendje për t'i përmbushur kërkesat standarde të BE-së për të drejtat e njeriut në sigurimin e mbrojtjes së të drejtave themelore , megjithëse, zbatimi i tij mbetet një sfidë për të dhe institucionet e tjera të Kosovës.

Përveç legjislacionit primar, Avokati i Popullit ka miratuar legjislacionit sekondar në bazë të të cilit funksionon në zbatimin e mandatit të tij, i cili përfshin:

•**Rregullorja nr. 03/2017** për avancimin e karrierës dhe transferimin e punonjësve të Institucionit të Avokatit të Popullit;

•**Rregullorja nr. 02/2017** oper procedurën e emërimit, të rekrutimit dhe punës provuese të të punësuarve në Institucionin e Avokatit të Popullit;

•**Rregullorja nr. 01/2017** ër përshkrimin e vendeve të punës dhe klasifikimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit;

•**Rregullorja nr. 02/2016** për rregulloren e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit;

•**Rregullorja nr. 01/2016** për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit;

•**Rregullorja nr. 01/2015** për procedurën e konkursit dhe propozimin e listës me emrat e kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit;

•**Rregullore IAP nr.01/2019** për procedurat e veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave të paraqitura nga fëmijët apo ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve.

Përveç legjislacionit primar sipas "Paketës së të Drejtave të Njeriut" dhe legjislacionit sekondar të miratuar nga IAP-ja, disa ligje të tjera të miratuara nga ana e Kuvendit të cilat kanë ndikim në punën e IAP-së dhe në gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Këtu përfshihen Ligji nr. 06/ L-081 për Qasjen në Dokumente Publike, Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe legjislacioni i ri për paketën e reformës së administratës publike, që përfshin Ligjin nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë; Ligjin nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura të cilët kanë ndikim në legjislacionin dytësor të lartpërmendur.

Kapitulli XII i Kushtetutës përcakton rolin e institucioneve të pavarura, duke përfshirë rolin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit (nenet 132-135). Sipas Kushtetutës, roli dhe kompetencat e Avokatit të Popullit janë:

1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.


2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.

3. Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.

Sipas ligjit, Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex-officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Finalizimi i hetimit, i iniciuar sipas ankesës apo me iniciativën e Avokatit të Popullit, rezulton me nxjerrjen e vendimit në të cilin paraqiten konstatimet dhe rekomandimet e tij.

Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor, megjithëse ai nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura të tjera ligjore që janë duke u zhvilluar në gjykata, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave. Gjithashtu Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimit, mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese si dhe ushtron kompetencat e veta edhe me anë të ndërmjetësimit dhe pajtimit.

Në kuadër të Avokatit të Popullit funksionon edhe Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (MKPT). Në këtë kuadër Avokati i Popullit është i obliguar t'i vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut. Si rezultat Avokati i Popullit mund të japë sugjerime dhe rekomandime për personat dhe institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria, pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, për përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të tyre.



Avokati i Popullit kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me legjislacionin tjetër në fuqi; mbledh të dhëna statistikore për çështjet e diskriminimit dhe të barazisë të paraqitura te Avokati i Popullit, të cilat edhe i publikon; nxjerr raporte dhe jep rekomandime për politikën dhe për praktikën për luftimin e diskriminimit dhe për promovimin e barazisë; bashkëpunon me partnerët socialë dhe OJQ-të që merren me çështje të barazisë dhe kundër diskriminimit si dhe me trupa të ngjashëm ndërkombëtarë me Avokatin e Popullit.

Gjithashtu Avokati i Popullit ka edhe përgjegjësitë të angazhohet për eliminimin e shkeljeve dhe diskriminimit; të hartojë dhe të miratojë procedura të veçanta për pranimin dhe për trajtimin e ankesave për fëmijët, si dhe krijimin e ekipit të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe të programit të përhershëm për vetëdijësimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe për rolin e IAP-së për mbrojtjen e tyre; t'i bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe t'i rekomandojë qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve të tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe me avancimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut, të barazisë dhe të jodiskriminimit; t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve si dhe nxjerrjen apo ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut; të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit vendor me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe për liritë e njeriut, të barazisë dhe kundër diskriminimit, dhe të kryejë hulumtime për çështjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, të barazisë dhe kundër diskriminimit; në pajtim me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi, të bashkëpunojë me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut; ta ruajë fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të të dhënave që i merr, duke u kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Analiza e situatës dhe identifikimi i sfidave kryesore është bërë gjatë fazës paraprake të hartimit të Strategjisë përmes vlerësimit të zbatimit të Strategjisë së IAP-së 2017-2019. Raporti i vlerësimit është bazuar në dokumentet në dispozicion për punën e IAP-së gjatë tri vjetëve të fundit e sidomos raportet vjetore të IAP-së për 2017 dhe 2018 si dhe informatat e ofruara nga IAP-ja me shkrim dhe përmes takimeve qoftë gjatë hartimit të raportit apo gjatë hartimit dhe rishikimit të tekstit të Strategjisë në dhjetor 2020. Prandaj, me qëllim të ndërlidhjes së nevojave ekzistuese dhe orientimeve strategjike si dhe masave që do të ndërmerren për të adresuar këto nevoja, ky kapitull i Strategjisë përfshin një përmbledhje të informatave për situatën aktuale dhe sfidave kryesore.

Besueshmëria për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore




Figura 1. Të dhënat krahasuese të Anketës së Barometrit të Ballkanit në pyetjen "Sa keni besim në institucione të caktuara?" (%)

Bazuar në raportet e jashtme, siç janë Raporti i Progresit i KE-së dhe sondazhet e Opinioneve Publike të Barometrit Ballkanik, Institucioni i Avokatit të Popullit renditet si institucioni më i besueshëm në Republikën e Kosovës gjatë katër vjetëve të fundit me 42% të besueshmërisë në vitin 2020. Për më tepër, bazuar në Studimin e Barometrit Ballkanik, perceptimi i qytetarëve është se IAP-ja mbetet institucioni më i pavarur nga ndikimi politik duke mos përfshirë perceptimin e publikuar për mediat. Në nivelin rajonal, Avokati i Popullit perceptohet si autonom nga ndërhyrjet politike nga numri më i madh i individëve të anketuar. Shkalla mesatare në Ballkanin Perëndimor është 34%, ndërsa në Kosovë, numri i qytetarëve që e perceptojnë Institucionin e Avokatit të Popullit si autonom nga ndikimi politik në vitin 2020 ishte 37%. Sidoqoftë, mbetet një sfidë pasi tendenca e perceptimit të qytetarëve për besimin, si dhe rreth formës së pavarësisë, besimi i qytetarëve ka rënë në vitin 2020 në krahasim me tri vjetët e mëparshme (Figura 1).

Raporti për zbatimin e Strategjisë së IAP-së vlerëson se është shënuar ngritje e performancës së IAP-së gjatë viteve të fundit në krahasim me situatën para se të fillonte zbatimi i Strategjisë. Ky vlerësim mbështetet nga shifrat të cilat tregojnë se vëllimi i punës së IAP-së është rritur gjatë viteve të fundit, numri i rekomandimeve të zbatuara është më i lartë se më parë, numri i rasteve të filluara me iniciativë që kanë rezultuar me raporte është rritur. Një numër i indikatorëve të tjerë tregojnë gjithashtu një trend të përmirësimit të performancës së IAP-së.

Përkundër asaj që IAP-ja mbetet institucioni më i besuar në Kosovë dhe institucioni i dytë me shkallë të besimit në rajon, sfida mbetet pasi trendi i perceptimit të qytetarëve për besimin, si dhe mbi formën e pavarësisë nga ndikimi politik ka rënë në vitin 2019 në krahasim me dy vjetët e kaluara. Përveç kësaj, përkundër angazhimit aktiv të IAP-së në fushën e ndërgjegjësimit, veçanërisht gjatë vitit 2017 dhe 2018, sfida e vazhdueshme për vetëdijësim dhe informim mbetet akoma relativisht e ulët në mesin e publikut të gjerë për mandatin dhe kompetencat e IAP-së, gjë që reflektohet nga pothuajse gjysma e ankesave jo të pranueshme (të mbyllura si të papranueshme) të paraqitura në institucion.

Fokusimi në çështje sistematike të drejtave të njeriut dhe lirive themelore ato të cilat janë më të rëndësishme për interesin dhe shqetësimet e qytetarëve




Figura 2. Rastet sipas detyrës zyrtare

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një mekanizëm monitorues, luan një rol të rëndësishëm në rritjen e llogaridhënies së administratës shtetërore. Ai po ashtu mund të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së administratës duke zbuluar rastet e "keqadministrimit" dhe duke ngritur vetëdijen në lidhje me qeverisjen e mirë. Përkundër resurseve të kufizuara, mungesës së bashkëpunimit të duhur ndërinstitucional dhe mjedisit politik sfidues në të cilin funksionon, institucioni ka qenë shumë aktiv. Strategjia e IAP-së 2017-2019 synonte që IAP-ja të përqëndrohet në shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Këto raste zakonisht iniciohen zyrtarisht nga IAP-ja. Raportohet se gjatë tri vjetëve të fundit trendi i çështjeve të iniciuara sipas detyrës zyrtare është rritur nga 56 sa ishte në vitin 2016, në 72 raste në vitin 2018, ndërsa gjatë vitit 2019 numri i tyre është 54. Po ashtu, numri i raporteve për rastet e hetuara sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar nga viti në vit. Përderisa ai numër është rritur nga 12 sa ishte në vitin 2016 në 14 në vitin 2018, gjatë vitit 2019 numri i raporteve për rastet e hetuara ex-officio ishte 11 (shih Figura 2). Tendanca në rritje gjatë viteve paraprake që u është kushtuar hetimeve ex-officio, kryesisht të lidhura me shkeljet e vazhdueshme të të drejtave dhe lirive të njeriut, me qëllim sigurimin e një ndikimi më të madh në përmirësim të sistemit për mbrojtjen e të drejtave të tilla duhet të vazhdohet edhe gjatë viteve të ardhme.

Numri më i madh i rasteve të hetuara nga IAP-ja kanë qenë kryesisht përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; të drejtën për mjete juridike; të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit; mbrojtjen shëndetësore dhe sociale; mbrojtjen e pronës etj.

IAP-ja vazhdimisht ka marrë pjesë gjerësisht në procesin e hartimit të legjislacionit duke dhënë komente për nismat legjislative dhe duke dhënë rekomandime në lidhje me nevojat për ndryshime legjislative. Gjithashtu, dy vjetëve të fundi, IAP-ja i është referuar Gjykatës Kushtetuese me katër kërkesa për shqyrtim të kushtetutshmërisë, përfshirë këtu kërkesat për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy ligjeve: Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik.

Shkalla e zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit




Figura 3. Statusi i rekomandimeve

Rekomandimet e leshuara nga Avokati i Popullit janë një nga instrumentet thelbësore, përmes së cilave kontribuohet në mbrojtje të të drejtave të njeriut, qeverisje të mirë, transparencë dhe llogaridhënie të institucioneve. Vlerësohet se gjatë viteve të kaluara ka pasur luhajtje në shkallën e zbatimit të rekomandimeve të IAP-së nga institucionet të cilave ato u janë drejtuar. Sipas Raportit Vjetor të IAP-së për vitin 2019, janë zbatuar 55 rekomandime (ose 25%) nga numri i përgjithshëm i rekomandimeve, nuk janë zbatuar 12 (5%) rekomandime dhe 158 rekomandime (70%) janë duke pritur për zbatim. Sipas Raportit Vjetor të IAP-së për vitin 2018, 99 rekomandime (ose 38%) nga numri i përgjithshëm i rekomandimeve janë zbatuar, 29 (11%) të rekomandimeve të tij nuk janë zbatuar dhe 135 rekomandime (51%) janë duke pritur për zbatim (Figura 3). Në vitin 2017, shkalla e zbatimit të rekomandimeve ishte 31%, ndërsa shkalla e rekomandimeve të pazbatuara ishte 30%. Pjesa e rekomandimeve në pritje të vitit 2017 ishte 39%.

Institucionet të cilat gjatë vitit 2019 kanë pasur numër më të madh të rekomandimeve të pranuar dhe të pazbatuara dhe tek të cilat duhet përqendruar theksin gjatë viteve në vijim, janë:

- **Ministria e Drejtësisë, nga 54 rekomandime të pranuar, 16 rekomandime ose 30% të tyre i ka zbatuar, 4 rekomandime ose 7% nuk i ka zbatuar, 34 rekomandime ose 63% janë në pritje;**
- **Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nga 31 rekomandime të pranuar, 5 rekomandime ose 16% të tyre i ka zbatuar, 2 rekomandime ose 7% nuk i ka zbatuar, 24 rekomandime ose 77% të tyre janë në pritje;**
- **Ministria e Punëve të Brendshme, nga 14 rekomandime të pranuar, 3 rekomandime ose 21% të tyre i ka zbatuar, ndërsa 11 rekomandime ose 79% të tyre janë në pritje;**
- **Policia, nga 16 rekomandime të pranuar, 3 rekomandime ose 19% të tyre i ka zbatuar, 1 rekomandim ose 6% nuk e ka zbatuar, dhe 12 rekomandime ose 75% të tyre janë në pritje;**
- **Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nga 9 rekomandime, asnjë nuk e ka zbatuar, 8 rekomandime janë në pritje, ndërsa një rekomandim nuk është zbatuar.**

Zbatimi i rekomandimeve të IAP ende mbetet një nga sfidat kryesore megjithë trendin në rritje që paraqitet edhe nga statistikat më lartë. Një kategori e rekomandimeve që paraqesin sfidë për IAP-it paraqitet edhe numri i madh i rekomandimeve që janë në pritje numri i të cilave në fund të viti 2019 ka shënuar në 158 rekomandime.

Shqetësimi se “zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet e Kosovës mbetet një sfidë” është ngritur edhe nga Komisioni Evropian në raportin e Progresit për vitin 2020. Prandaj nevojitet përqendrimi i mëtejshëm për rritjen e shkallës së zbatimit dhe ndërtimi i mekanizmave të përshtatshëm për këtë qëllim. Mekanizmi SBS është një nga instrumentet efektive për këtë qëllim. Sidoqoftë, ky mekanizëm nuk përfshin institucionet e pushtetit lokal. Një çështje tjetër për t’u theksuar është mungesa e mekanizmave për t’u përqendruar në institucione që marrin numër më të madh rekomandimesh dhe shkaktojnë më shumë shkelje, siç janë: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Brendshme, Policia e Kosovës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Përveç kësaj, me qëllim të ngritjes së llogaridhënies nga ana e institucioneve për moszbatimin e rekomandimeve të IAP-së, por edhe për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, rol të rëndësishëm luan funksionimi i komisioneve të Kuvendit dhe bashkëpunimi i tyre me IAP-në. Në anën tjetër, për të përmirësuar koordinimin e saj për të drejtat e njeriut, qeveria, në maj të vitit 2016 ka themeluar një Grup Punues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut, i cili kryesohet nga kryeministri dhe përbëhet nga Avokati i Popullit, ministritë kryesore, organizatat e shoqërisë civile dhe agjencitë e tjera relevante që kontribuojnë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Grupi Punues Ndërministror është dashur të takohet tri herë në vit. Me gjithë disa takime të mbajtura, rezultati i tyre ka qenë minimal.

Ngritja e kapaciteteve të Institucionit të Avokatit të Popullit

Si institucion kombëtar i të drejtave të njeriut, i themeluar në përputhje me Parimet e Parisit dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, roli i IAP-së në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore është thelbësor, prandaj rëndësi themelore ka zhvillimi i kapaciteteve të nevojshme të stafit në këtë drejtim. Kapacitetet e IAP-së vazhdimisht janë fuqizuar si rezultat i angazhimit aktiv të stafit të tij dhe bashkëpunimit në aktivitete të ndryshme për krijimin e kapaciteteve me organizata të shumta ndërkombëtare, institucione të Kosovës dhe aktorë të tjerë. Ky konstatim mbështetet nga rezultatet e paraqitura në kapitullin e mëparshëm në lidhje me rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve si dhe trendin pozitiv të punës së IAP-së në trajtimin e të gjitha kategorive të rasteve dhe situatave, si dhe raportin e KE-së 2020, duke vlerësuar: "Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë ... ka rritur më tej kapacitetet për të shqyrtuar rastet dhe ka vazhduar përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin mbi mbrojtjen dhe rivendosjen e të drejtave të njeriut." Në bazë të informacionit, numri i ngjarjeve ndërkombëtare për ndërtimin e kapaciteteve të IAP-së është rritur në vitin 2018 në krahasim me dy vjetët e kaluara. Gjatë dy vjetëve të kaluara (2017-2019), mbi 54 trajnime janë siguruar për administratën dhe stafin profesional të IAP-së. Stafi i IAP-së mori pjesë gjithashtu në 36 aktivitete që kanë pasur për qëllim bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ngritjen e kapaciteteve të tij. Një vlerësim i nevojave për trajnim dhe plani i trajnimeve janë hartuar nga projekti i Komisionit Evropian Mbështetje për IAP-në gjatë vitit 2019.

Raporti për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë së IAP-së 2017-2019 ka evidentuar se me gjithë rritjen e kapaciteteve të institucionit, ka ende sfida dhe mangësi në lidhje me resurset dhe kapacitetet e kufizuara të stafit të IAP-së. Informacioni i plotë mbi pjesëmarrjen në ngjarjet e ngritjes së kapaciteteve, numrin e stafit të trajnuar dhe informacione të tjera përkatëse duhet të jenë në dispozicion në baza të rregullta për qëllim të zbatimit të kësaj Strategjie. Vlerësim i nevojave për trajnim i hartuar nga Projekti i Bashkimit Evropian Mbështetje për IAP-në dhe hartimi i planit të trajnimit do të synojnë t'i adresojnë mangësitë në kapacitetet e IAP-së. Situata pas hartimit të planit është gjithashtu një mundësi për të vendosur një sistem të vlerësimit të rregullt të ngritjes së kapaciteteve, planifikim të trajnimeve, raportim dhe dhënie e informacioneve për trajnimet. Fillimi i zbatimit të këtij plani të trajnimeve ka filluar më ngadalë sesa që ishte paraparë gjatë vitit 2020, për shkak të situatës së re të krijuar dhe sfidave si pasojë e pandemisë Covid-19.

Qëllimet strategjike

Mbrojtja dhe mbikëqyrja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përmes ndikimit të shtuar të Institucionit të Avokatit të Popullit në përmbushjen e mandatit të tij

01

Arritja e këtij objektivi strategjik bëhet përmes arritjes së objektivave specifike, si në vijim:

Objektivi specifik 1.1

Mbrojtja dhe mbikëqyrja e respektimit të të drejtave të njeriut, me fokus edhe në rastet sistematike me interes të përgjithshëm

Objektivi specifik 1.2

Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit në shqyrtimin e ankesave dhe rasteve ex-officio

Objektivi specifik 1.3

Rritja e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të IAP-së

Objektivi specifik 1.4

Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës

Objektivi specifik 1.1: Mbrojtja dhe mbikëqyrja e respektimit të të drejtave të njeriut, me fokus në rastet sistematike me interes të përgjithshëm

Institucionet e Ombudsmanit kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në forcimin e demokracisë, sundimit të ligjit, administrimit të mirë dhe mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Fokusimi kryesor i IAP-së është në mbrojtjen e të drejtave të njeriut përmes shqyrtimit të ankesave, inicimin e rasteve sipas detyrës zyrtare, ofrimit të rekomandimeve profesionale dhe kujdesit që ato të zbatohen. Me qëllim të përqendrimit më të madh në rastet e shkeljeve sistematike dhe atyre që kanë ndikim tek qytetarët, IAP-ja do të ndërmarrë masa adekuate dhe riprioritizimin e punës në raport me rastet sipas ankesave, qoftë përmes caktimit të stafit përkatës në secilin departament, i cili do të merret me shkeljet sistematike, qoftë përmes ndarjes së kohës së mjaftueshme për t'u marrë më shkeljet e tilla. Gjithashtu synohet angazhim proaktiv i stafit përmes hulumtimeve dhe analizave për tema të caktuara të cilat mund të shpijnë në identifikimin dhe analizimin e shkeljeve sistematike nga ana e institucioneve. Angazhimi i IAP-së gjithashtu do të konsistojë në rritjen e numrit të vizitave në institucione, sidomos nga Mekanizmi për Parandalim të Torturës, i cili do të ndikojë në parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Gjatë përgatitjes së rasteve për shqyrtim, stafi i IAP-së ka nevojë për informata, analiza dhe hulumtime shtesë për tema të caktuara, të cilat janë me interes dhe që ndihmojnë në rritjen e kualitetit të analizës së tyre. Prandaj kërkohet forcim i segmentit të hulumtimit në tema për të cilat konsiderohet se janë paraqitur shkelje sistematike, apo shkelje të të drejtave të njeriut të cilat prekin masa të gjëra të popullatës. Në shërbim të kësaj dhe me qëllim të shfrytëzimit më racional të burimeve ekzistuese të brendshme dhe të jashtme, IAP-ja mund të bashkëpunojë edhe me organizata të ndryshme të specializuara për hulumtime, qoftë ato të shoqërisë civile, donatorë apo të tjera. Zhvillimi i hulumtimeve dhe studimeve që kanë për subjekt tema të tilla kërkon burime financiare dhe njerëzore, prandaj duhet një planifikim vjetor apo afatmesëm, përmes të cilit përcaktohen temat e studimeve dhe afatet kohore. Kjo ndihmon në identifikimin e burimeve financiare dhe të tjera të nevojshme, të cilat kërkojnë planifikim dhe përgatitje paraprake.

Objektivi specifik 1.2: Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit në shqyrtimin e ankesave dhe rasteve ex-officio

Përderisa zbatimi i rekomandimeve dhe qeverisja e mirë në administratën publike janë faktorë kryesisht jashtë kontrollit të Institucionit të Avokatit të Popullit, efikasiteti dhe kualiteti i proceseve të punës, si: vendosja për pranimin e ankesave, udhëheqja e hetimeve dhe nxjerrja e rekomandimeve, janë faktorë të cilët në të shumtën e herave varen nga mënyra e organizimit të punës brenda institucionit, kapaciteti profesional i stafit, qartësia e rolit dhe detyrave, mjetet e nevojshme për ndarjen dhe procesimin e informatave etj. Qasja e duhur në gjetjen e zgjidhjeve të duhura dhe përdorimit të tyre ndikon direkt në efikasitetin dhe efektivitetin e punës së IAP-së, si në shqyrtimin e ankesave, ashtu edhe të rasteve ex-officio.

Për të rritur kualitetin e punës dhe efikasitetin në shqyrtimin e rasteve, sidomos atyre të iniciuara sipas ankesave, synohet të bëhet ndarja e rasteve, në radhë të parë sipas rolit dhe përgjegjësisë dhe specializimit të departamenteve, ndërsa ndarja e punës në mënyrë të baraspeshuar mund të arrihet pas vlerësimeve periodike në lidhje me ngarkesën e punës mes departamenteve.

Zvogëlimi dhe mënjanimi i lëndëve të vjetra synohet të bëhet përmes një shqyrtimi dhe diskutimi ndërfunksional në kuadër të IAP-së në mënyrë periodike, i cili bëhet në baza vjetore me qëllim evidentimin e arsyeve të vjetërimit dhe ndërmarrjes së masave për mënjanimin e tyre. Synohet gjithashtu hartimi i procedurave standarde operative apo udhëzuesve për menaxhimin e ankesave dhe rasteve ox-officio.

Një nga masat që parashihet të ndërmerret është matja e kënaqshmërisë së ankuesve me punën e IAP-së. Matja e kënaqshmërisë së punës së IAP-së bëhet përmes një pyetësi të shkurtër, të cilin kërkohet ta plotësojnë ankuesit pas përfundimit të rastit. Rezultatet e procesit të matjes mund të përmbledhen të një analize, e cila hartohet në baza vjetore dhe shërben për qëllime të brendshme dhe është mjet i rëndësishëm, i cili ka për qëllim përmirësimin e proceseve dhe kualitetit të punës së IAP-së.

Një segment tjetër që lidhet me efikasitetin dhe efektivitetin e punës së IAP-së është qartësimi i rolit dhe përgjegjësisë së njësive brenda institucionit për trajtimin e rasteve (ankesave, rasteve dhe çështjeve të iniciuara me vetiniciativë). Në këtë kontekst, pas ristrukturimit të strukturës organizative të vitit 2017 dhe përcaktimit të rolit dhe përgjegjësisë mes departamenteve të institucionit, kërkohen përmirësime të mëtejme, sidomos përveç disa segmenteve në zyrën qendrore, edhe në qartësimin e rolit dhe përgjegjësisë të stafit në zyrat rajonale, vijave të komunikimit të tyre dhe përgjegjësisë me eprorët në zyrën qendrore. Përmirësimet e tilla mund të bëhen pas një rishikimi funksional të strukturës organizative të IAP-së në nivel qendror dhe rajonal dhe rishikimit të bazës ligjore që rregullon strukturën organizative të tij. Përmirësimi i sistemit të monitorimit të rasteve dhe menaxhimit të informatave në IAP dhe mënjanimi i disa mangësive në sistemin aktual të menaxhimit të rasteve do të ndikojë në plotësimin e informatave, gjenerimin automatik të tyre. Kjo për më tepër mundëson monitorimin e procesimit të lëndëve përmes sistemit elektronik. Prandaj krijimi i një sistemi të ri elektronik apo zhvillimi i mëtejme i atij ekzistues është një nga mjetet për të përmirësuar gjendjen në këtë fushë.

Objektivi specifik 1.3: Rritja e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të IAP-së

Një aspekt i veçantë i punës së Avokatit të Popullit është ndikimi në punën e administratës shtetërore dhe në institucione të tjera publike. Ndikimi i tillë i punës së Avokatit të Popullit jep një kontribut të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të të drejtave të njeriut, parandalimin e keqqueverisjes dhe funksionimin e një administrate të mirë publike. Roli i Avokatit të Popullit, si një mekanizëm për mbikëqyrjen e administratës shtetërore dhe organeve të tjera publike është i sfiduar për faktin se rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk janë të obligueshme për institucionet të cilave u adresohet. Prandaj zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit mbetet ende një nga sfidat kryesore. Për këtë arsye masat që duhet t'i ndërmarrë për ta arritur qëllimin e tij janë të shumanshme.

Struktura dhe sfera e marrëdhënieve mes Kuvendit dhe Avokatit të Popullit ka ndryshuar në vitet e mëhershme në favor të tij. Avokati i Popullit gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në funksionimin e komisioneve të Kuvendit. Në këtë drejtim, konsiderohet se krijimi i një qasjeje të strukturuar dhe proaktive për bashkëpunim me Kuvendin do të ndikojë dukshëm në rritjen e ndikimit të tij dhe përmirësimin e llogaridhënies nga institucionet e tjera. Ky bashkëpunim përveç tjerash, mund të forcohet përmes organizimit të konferencave, tryezave të rrumbullakëta dhe punëtorive mes IAP-së dhe Kuvendit, e në veçanti me komisionet parlamentare përkatëse. Rritja e bashkëpunimit me Kuvendin do të ndikojë edhe në ngritjen e kualitetit të punës së IAP-së në përmirësimin e procesit të hartimit, rishikimit dhe miratimit të legjislacionit.

Përmirësimi i gjendjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe zbatimi i rekomandimeve të IAP-së kërkon përpjekje dhe koordinim ndërmjet të gjitha institucioneve të Kosovës, ndërsa në këtë drejtim bashkëpunimi me sistemin gjyqësor, qeverinë dhe pushtetin lokal është faktor kryesor.

Për përmirësimin e koordinimit me qeverinë, por edhe me palë të tjera të interesit, funksionalizimi dhe ridizajnimi i Grupit Punues Ndërministror për të drejtat e njeriut është çelësi përmes të cilit mund të vendoset mekanizmi i cili ndihmon në arritjen e këtij objektivi të Strategjisë. Përveç koordinimit të përgjithshëm, fokusimi në institucione të cilat kanë më shumë rekomandime të pazbatuara dhe krijimi i mekanizmave të koordinimit, si në nivel të institucioneve të qeverisë qendrore, ashtu edhe në nivel lokal.

Marrëdhënia midis BE-së dhe Kosovës është një faktor shumë i rëndësishëm duke marrë se BE-ja është e angazhuar në përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë. Prandaj shfrytëzimi i të gjithë mekanizmave të integritetit, por edhe i mekanizmave të tjerë të institucioneve ndërkombëtare, si: Këshilli i Evropës, OSBE-ja dhe anëtarësimi në mekanizma ndërkombëtarë, do të ndikojnë në rritjen e ndikimit të Avokatit të Popullit në përmirësimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë.

Objektivi specifik 1.4: Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës

Me qëllim të mbikëqyrjes së legjislacionit në raport me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, IAP-ja do t'i fokusojë dhe rrisë aktivitetet në segmente si në vijim:

- **Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit , IAP-ja do t'u japë rekomandime institucioneve për ndërmarrjen e iniciativave ligjore për projektligje të reja apo ndryshimin e projektligjeve apo të akteve nënligjore;**
- **T'i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv;**
- **IAP-ja gjithashtu mund të japë rekomandime për përputhshmërinë e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore apo administrative, udhëzuesve dhe të praktikave të aplikuara në Kosovë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera të trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtërues;**
- **IAP-ja do të japë rekomandime për legjislacionin i cili është në proces të hartimit, qoftë përmes fazës paraprake të konsultimit, konsultimeve publike përmes platformës elektronike të konsultimeve publike , apo përmes pjesëmarrjes dhe kontributit në komisione përkatëse parlamentare.**

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve dhe caqeve si në vijim:

Qëllimi strategjik 1.

Mbrojtja dhe mbikëqyrja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përmes ndikimit të shtuar të Institucionit të Avokatit të Popullit në përmbushjen e mandatit të tij

Qëllimi strategjik 1.1.

Mbrojtja dhe mbikëqyrja e respektimit të të drejtave të njeriut, me fokus edhe në rastet sistematike me interes të përgjithshëm

Treguesit	Baza referente	Caku 2023	2025
1.Numri i rasteve ex-officio të iniciuara nga ana e IAP-së	43(2020)	46	49
2.Numri i raporteve për rastet ex- officio	5(2020)	6	7
3.Numri i Amicus Curiea	4(2020)	4	4
4.Numri i opinioneve	3(2020)	5	5
5.Numri i vizitave nga MKPT-ja	52(2020)	60	70
6.Numri i rasteve të hetuara për torturën dhe trajtimin johuman	38(2020)	45	50
7.Numri i rasteve të hetuara për të drejtat e fëmijëve	41(2020)	50	60
8.Numri i rasteve të hetuara me bazë diskriminimin	107 (2020)	110	120

Objektivi specifik 1.2: Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit në shqyrtimin e ankesave dhe rasteve ex-officio

1.Numri i ankesave të pranuar nga Institucionit i Avokatit të Popullit	1419 (2020)	1800	2200
2.Numri i rasteve të hetuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit	720 (2020)	900	1100
3.Përqindja e rasteve nga ankesat të përfunduara brenda afatit 6 mujor	30 2020 %	37%	45%
4.Përqindja e rasteve ex-officio të përfunduara brenda afatit 6 mujor	14 2020 %	20%	25%
5.Përqindja e rasteve sipas ankesës të përfunduara brenda një viti	40 2020 %	46%	54%
6.Koha mesatare e shqyrtimit gjatë fazës së pranimit të ankesave	0	Plotësohet pas raportit të vitit të parë	Plotësohet pas raportit të vitit të parë
7.Koha mesatare e shqyrtimit të ankesave nga pranimi deri në mbylljen e rasteve	0	Plotësohet pas raportit të vitit të parë	Plotësohet pas raportit të vitit të parë

Objektivi specifik 1.3: Rritja e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të IAP-së

1.Përqindja e rekomandimeve të IAP-së në të cilat institucionet e nivelit qendror i përgjigjen IAP-së	(2020) 71%	78%	85%
2.Përqindja e rekomandimeve të IAP-së në të cilat institucionet e nivelit lokal i përgjigjen IAP-së	(2020) 56%	65%	75%
3.Përqindja e rekomandimeve të IAP-së të zbatuara nga institucionet e nivelit qendror	18% (2020)	24%	28%
4.Përqindja e rekomandimeve të IAP-së të zbatuara nga institucionet e nivelit lokal	20% (2020)	26%	31%
5.Numri i procedurave të iniciuara për mospërgjigje ndaj kërkesave të Avokatit të Popullit	0	Plotësohet pas raportit të vitit të parë	Plotësohet pas raportit të vitit të parë
6.Numri i procedurave të iniciuara për pengim në punën e Avokatit të Popullit	0	Plotësohet pas raportit të vitit të parë	Plotësohet pas raportit të vitit të parë

Objektivi specifik.1.4: Mbikëqyrja e legjislacionit në raport me të drejtat dhe liritë e njeriut në Kosovë

1.Numri i rekomandimeve të paraqitura për ndryshim-plotësimin e akteve nënligjore dhe për nxjerrjen e akteve të reja nënligjore të legjislacionit të përfshira në akte ligjore/nënligjore	19	3	3
2.Numri i rekomandimeve për ndryshim-plotësimin e ligjeve dhe për nxjerrjen e akteve të reja ligjore	1 (2020)	1	2
3.% of cases according to the complaints completed within 6 months	0 (2020)	3	3

6.2. Qëllimi strategjik 2

Promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe roli i IAP-së

Arritja e këtij objekti strategjik bëhet përmes arrtjes së objektivave specifike si në vijim:

Objektivi specifik 2.1

Vetëdijesimi i publikut për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut

Objektivi specifik 2.2

Promovimi dhe edukimi për të drejtat e njeriut tek institucionet përgjegjëse për zbatimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore në vend

Objektivi specifik 2.3

Rritja e bashkëpunimit të IAP-së me institucionet e tjera dhe me organizata joqeveritare

Objektivi specifik 2.4

Avancimi i komunikimit të vazhdueshëm dhe ndërgjegjësimit për rolin dhe rëndësinë e IAP-së

Objektivi specifik 2.1: Vetëdijesimi i publikut për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut

Gjatë periudhës së ardhme afatmesme, IAP-ja do të fokusohet në aktivitete të vetëdijesimit të publikut për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut me fokus të veçantë për të drejtat dhe liritë e kategorive të caktuara të personave. Këtu hyjnë të drejtat dhe liritë e fëmijëve, të drejtat e gruas, të drejtat dhe liritë e personave me nevoja të veçanta, personave të cilët janë më të cenueshëm, të drejtave të personave të cilëve për shkak të kryerjes së veprave penale janë duke vuajtur dënimin etj. Shtimi i aktiviteteve për këto kategori do të konsistojë në hulumtime tematike për të drejtat e njeriut, analiza dhe publikime të tyre për rastet sistematike, organizim dhe shënim të përvjetorëve dhe ditëve të veçanta për të drejtat e njeriut etj. IAP-ja, përveç raporteve vjetore, me anë të të cilave raporton për punën e vet, si dhe hulumtimeve për tema specifike, do ta shqyrtojë publikimin e një buletini periodik, me anë të të cilit publikohen informata specifike, praktika të mira dhe aktivitete të veçanta që kanë të bëjnë me vetëdijësimin e publikut për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Objektivi specifik 2.2: Promovimi dhe edukimi për të drejtat e njeriut tek institucionet përgjegjëse për zbatimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore në vend

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë periudhës së ardhme afatmesme do të jetë aktiv në organizimin e fushatave, konferencave dhe ngjarjeve të ndryshme, të cilat kanë për qëllim promovimin dhe informimin e publikut për rolin dhe rëndësinë e punës së Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. I një rëndësie të veçantë është bashkëpunimi me organizata dhe palë të tjera të interesit, me qëllim të ndërmarrjes së aktiviteteve edukative, të cilat mund të ndajnë njohuritë dhe informojë palët potenciale për mundësitë që ofrohen nga shërbimet e IAP-së sipas kompetencave dhe përgjegjësisive të tij.

IAP-ja gjithashtu do të sigurojë prani dhe promovojë rolin dhe rëndësinë e IAP-së përmes përfaqësimit të Avokati i Popullit në ngjarje dhe konferenca kryesore, të cilat organizohen nga institucionet dhe palët e tjera. Prania e IAP-së në konferenca, tryeza dhe ngjarje të rëndësishme është qëllim dhe mjet për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të publikut. IAP-ja do të fokusohet të sigurojë përfaqësimin e vet, përveç në ngjarje të rëndësishme që organizohen brenda shtetit, edhe në ngjarje në rajon si dhe në nivel më të gjerë ndërkombëtar.

Objektivi specifik 2.3: Rritja e bashkëpunimit të IAP-së me institucionet e tjera dhe me organizata joqeveritare

Institucioni i Avokatit të Popullit synon të rrisë bashkëpunimin e tij në fushën e të drejtave të njeriut me institucionet lokale, me organizatat ndërkombëtare në Kosovë dhe me shoqërinë civile, me qëllim të përmbushjes së obligimit për promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe të mandatit të IAP-së. Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me palët kryesore të interesit ka qenë një çështje kryesore për informimin e tyre për rolin dhe përgjegjësitë e IAP-së. Fushatat derë më derë dhe lidhja e drejtpërdrejtë midis IAP-së dhe ankuesit mund të krijohet nga OJQ-të që merren me grupe të marginalizuara. Prandaj, gjatë gjithë fushatës së komunikimit synohet përfshirja dhe partneriteti mes organizatave të shoqërisë civile të cilat do të kontribuojnë në forcimin e angazhimit të OJQ-ve në procesin e politikave (duke u kushtuar vëmendje të veçantë organizatave në nivel lokal) përmes dialogut të strukturuar ndërmjet IAP-së dhe shoqërisë civile dhe përmes realizimit të ngjarjeve të ndryshme të komunikimit.

Objektivi specifik 2.4: Avancimi i komunikimit të vazhdueshëm dhe ndërgjegjësimi për rolin dhe rëndësinë e IAP-së

Atributi kryesor tradicional i Avokatit të Popullit është hapja, informimi dhe puna me mediat. Përmes aktiviteteve të fokusuara të komunikimit dhe rritjes së vetëdijesimit pritet të kontribuohet që të ketë një dukshmëri më të madhe të IAP-së dhe një kuptim më të mirë të mandatit dhe aktiviteteve të tij. Në përgjithësi, duke kontribuar për një bashkëpunim më të mirë ndërmjet IAP-së dhe shoqërisë civile, me qëllim të mbrojtjes më të mirë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe do të përmirësojnë komunikimin ndërmjet IAP-së dhe institucioneve publike përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Për të vlerësuar perceptimin e qytetarëve dhe për të matur ndikimin e aktiviteteve të komunikimit dhe vetëdijesimit të IAP-së, synohet të organizohen hulumtime të opinionit publik për matjen e qëndrimeve (dhe ndryshimit të qëndrimeve) tek një segment më i madh i popullsisë, në dy fushata vetëdijesimi në të gjithë vendin, të cilat do të hartohen dhe zbatohen, me fokus në mandatin e IAP-së dhe arritjet e tij. Qëllimi i fushatave është që të përcillet ndikimi i aktiviteteve të IAP-së në opinionin e qytetarëve për mandatin dhe përgjegjësitë e tij.

Ndërgjegjësimi për rolin, përgjegjësitë dhe rëndësinë e punës së IAP-së përfshinë aktivitete shumëdimensionale dhe përdorim të mjeteve të ndryshme. Strategjia përmes këtij objektivi synon të promovojë rolin e IAP-së, të përmirësojë dukshmërinë e tij dhe të rrisin vetëdijen publike dhe të kuptuarit e mandatit dhe aktiviteteve të institucioneve. Kështu, në fund të periudhës së zbatimit të projektit, një numër i madh i palëve të interesuara (OJQ, media, grupe të cënueshme/grupe të diskriminuara dhe audienca e përgjithshme) do të jetë i informuar më mirë për rolin e IAP-së në procesin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Kosovë. Përveç përdorimit të mjeteve klasike të promovimit dhe informimit do të shtohet përdorimi i mjeteve të teknologjisë informative, si dhe përdorimi i rrjeteve të caktuara sociale, siç janë: Facebook dhe Twitter. Në anën tjetër, vëmendje të veçantë do t'i kushtohet avancimit të komunikimit me mediat, sidomos përmes një qasjeje të strukturuar dhe aktive të komunikimit me ta.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve dhe caqeve si në vijim:

Qëllimi strategjik 2

Promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe roli i IAP-së

Objektivi specifik 2.1: Vetëdijesimi i publikut për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut

Treguesit	Baza referente	Caku 2023	Caku 2025
1.Numri i hulumtimeve të zhvilluara dhe publikuara nga ana e IAP-së me qëllim promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë	0	2 1 në vit	4
2.Numri i konferencave, seminareve, tryezave të rrumbullakëta të organizuara nga IAP-ja	0 konferenca ndërkombëtare 1 forum (2019) 10 tryeza (2019)	2 konferenca ndërkombëtare 6 forume 21 tryeza të rrumbullakëta (në secilin rajon) (7 tryeza në vit)	2 konferenca ndërkombëtare 2 forume 14 tryeza (7 në vit)

Objektivi specifik 2.2: Promovimi dhe edukimi për të drejtat e njeriut tek institucionet përgjegjëse për zbatimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore në vend

1.Platforma për të drejtat e njeriut e ripërpunuar dhe funksionalizuar			Platforma e funksionalizuar
2.Numri i aktiviteteve edukative për të drejtat e njeriut që IAP-ja zhvillon me institucionet përgjegjëse për zbatimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore në vend	2 fushata edukative (2019)	6 fushata, nga 2 çdo vit	Nga 2 çdo vit (4 fushata)

Objektivi specifik 2.3: Rritja e bashkëpunimit të IAP-së me institucionet e tjera dhe me organizata joqeveritare

1.Numri i MiM që IAP-ja nënshkruan me OJQ dhe organizata të tjera	3	9 3 në çdo vit	3 3 në çdo vit
2.Numri i iniciativave të përbashkëta me organizata të tjera (OJQ, organizata qeveritare, vendore dhe ndërkombëtare)	3 (2019)	Nga 3 çdo vit	Nga 3 çdo vit

Objektivi specifik 2.4: Avancimi i komunikimit të vazhdueshëm dhe ndërgjegjësimin për rolin dhe rëndësinë e IAP-së

1.Përqindja e rritjes së besueshmërisë së institucionit të IAP-së	42% (2020 Ballkan Barometer)	50%	60%
2.Numri i aktiviteteve promovuese dhe informuese të organizuara nga ana e Avokatit të Popullit	2 fushata promovuese (2019) 10 trajnime me studentë (2019)	3 fushata promovuese 6 fushata derë më derë 10 ditë të hapura në secilin vit	Në rritje 10 ditë të hapura në vit
3.Numri i informatave/ deklaratave/ njoftimeve të publikuara	54 (2020)	60 në secilin vit	70 në secilin vit
4.Numri i vizitave në ueb-faqe	89.393 (2020)	130.000	150.000
5.Numri i vizitave në mediat sociale	15.990 (2020)	30.000	40.000

6.3. Qëllimi strategjik 3

Promovimi i Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ)

Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshem prekin të gjitha segmentet dhe institucionet e vendit. Prandaj me zbatimin e tyre merren një numër i madh i institucioneve. Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 25 janar ka miratuar Rezolutën për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, ndërsa në tetor 2018, Kuvendi ishte pajtuar ta themelonte një Këshill për Zhvillim të Qëndrueshëm, të udhëhequr nga kryetari i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Ky Këshill funksionon si një subjekt monitorues për të siguruar që të arrihet mbarëvajtja e zbatimit të OZhQ-së. Në këtë kontekst, për t'i përmbushur obligimet e veta kundrejt këtyre sfidave, IAP-ja në vitin 2019 ka publikuar "Platformën për të Drejtat e Njeriut", e cila synon të promovojë zbatimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, siç garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me ligjet në Kosovë. Kjo Platformë përmban dy udhëzues: "Udhëzuesin e të Drejtave të Njeriut" dhe "Udhëzuesin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ)", të cilët do të shërbejnë për të siguruar qasje më të lehtë dhe praktike në juridiksionin vendor dhe ndërkombëtar përmes lidhjeve të strukturuar mes instrumenteve juridike, të cilat zbatohen drejtpërdrejt në sistemin juridik të Kosovës, si dhe për t'i demonstruar lidhjet e OZhQ-së me të drejtat dhe me liritë themelore të njeriut.

Objektivi specifik 3.1

Zhvillimi i programeve vetëdijesuese për promovimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Objektivi specifik 3.2

Zhvillimi në IAP i një sistemi për gjenerimin e të dhënave në raport me indikatorët e OZhQ-së mbi mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut

Objektivi specifik 3.3

Avancimi i kapaciteteve të stafit të IAP-së për promovimin e OZhQ-së, adresimin tyre dhe ndërlidhjen e tyre me të drejtat e njeriut

Objektivi specifik 3.4

Bashkëpunimi ndërkombëtar në ndërtimin e kapaciteteve reciproke, shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira me vendet rajonale drejt arritjes së progresit në promovimin dhe adresimin e OZhQ-së

Objektivi specifik 3.1: Zhvillimi i programeve vetëdijesuese për promovimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

IAP-ja përmes zbatimit të përgjegjësive të veta në promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut ka një rol të pazëvendësueshëm në promovimin dhe ngritjen e vetëdijës në promovimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Prandaj edhe mundësitë dhe iniciativat për promovimin e OZhQ-së në Kosovë nga ana e IAP-së janë të shumanshme. Në pajtim me Deklaratën e Meridas , IAP-ja gjatë periudhës së ardhme afatmesme do t'i ndër marrë aktivitetet si në vijim:

- **Organizimin e punëtorive dhe tryezave për të drejtat e njeriut dhe zhvillimin e qendrueshëm;**
- **Do të ofrojë këshilla për institucione në nivel qendror dhe lokal, përgjegjësit e të drejtave dhe aktorë të tjerë, për të promovuar një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut për zbatimin dhe matjen e Agjendës të OZhQ-së**
- **Zhvillimi dhe forcimi i partneriteteve për zbatim duke promovuar procese transparente dhe gjithëpërfshirëse për pjesëmarrje dhe konsultime me palët përgjegjëse të të drejtave të njeriut dhe shoqërinë civile në të gjitha fazat e zbatimit të Agjendës 2030, siç është zhvillimi i strategjive kombëtare për ta arritur OZhQ-në**
- **Angazhimi me bartës të detyrave, mbajtës të të drejtave dhe aktorë të tjerë kryesorë, duke përfshirë qeverinë, Kuvendin, gjyqësorin, autoritetet lokale, Agjencinë e Statistikave, shoqërinë civile, grupet e marginalizuara, mediat kryesore dhe mediat sociale, Kombet e Bashkuara dhe institucione të tjera ndërkombëtare dhe rajonale. Angazhimi me këto palë do të bëhet për të rritur ndërgjegjësimin, për të ndërtuar besimin, promovuar dialogun dhe përpjekjet e bashkërenduara për një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut për zbatimin dhe monitorimin e Agjendës së OZhQ-së.**

Objektivi specifik 3.2: Zhvillimi i një sistemi për gjenerimin e të dhënave në raport me indikatorët e OZhQ-së mbi mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në IAP

Treguesit do të jenë shtylla e monitorimit të progresit drejt OZhQ-së. Megjithatë, qasja në të dhëna dhe mbledhja e tyre për raportim të progresit në raport me arritjen e këtyre objektivave është një nga sfidat kryesore. Janë tri sfida të cilat paraqesin pengesa e që pamundësojnë vlerësimin e përpjekjeve të vendit drejt zbatimit të OZhQ-së :

- Mungesa e llogaridhënies, kur është fjala për ofrimin e të dhënave;
- Të dhënat e paqëndrueshme mes dhe brenda institucioneve and
- Të dhënat nuk kanë lidhje me objektivat e OZhQ-së.

Institucioni i Avokatit të Popullit do ta shfrytëzojë mandatin e dhënë nga Kushtetuta për të ndihmuar në ndërtimin e një sistemi të mbledhjes së të dhënave për të siguruar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në matjen e Agjendës së OZhQ-së, përfshirë përmes kërkimit të bashkëpunimit me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, dhe me institucionet e tjera përkatëse, dhe duke u bazuar në mekanizmat ekzistues ndërkombëtarë dhe vendorë të të drejtave të njeriut. Zhvillimi i Udhëzuesit të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm nga ana e IAP-së është vetëm një nga instrumentet të cilat do të pasohen nga hapa të tjerë. Kjo do t'i shërbejë monitorimit të progresit në zbatimin e Agjendës 2030 në nivel kombëtar dhe lokal për të vënë në pah pabarazinë dhe diskriminimin në këtë drejtim, përfshirë përmes qasjeve inovative për mbledhjen e të dhënave dhe krijimin e bashkëpunimit me bartësit e të drejtave, grupet e cënueshme dhe të marginalizuara për monitorimin pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës dhe duke identifikuar pengesat, si dhe veprimet për të arritur progres.

Objektivi specifik 3.3: Avancimi i kapaciteteve të stafit të IAP-së në promovimin e OZhQ-së, adresimin e tyre dhe ndërlidhjen e tyre me të drejtat e njeriut.

Zhvillimi i ekspertizës së nevojshme për OZhQ-në tek stafi i IAP-së është i nevojshëm nëse marrim parasysh specifikat e OZhQ-së dhe shtrirjen e tyre ndërsektoriale. Prandaj fokusimi inicial i IAP-së është zhvillimi i programeve të përshtatshme të trajnimit dhe ngritja e kapaciteteve, të cilat do të mundësojnë dhënien e kontributit të IAP-së në promovimin dhe monitorimin e tyre.

Iniciativat për zhvillim kapacitetesh do të jenë të përshtatura sa më shumë që të jetë e mundur me detyrat specifike dhe përshkrimet e punës aktuale të stafit të IAP-së, në mënyrë që angazhimi i tyre në promovimin, monitorimin dhe raportimin e OZhQ-së të jetë komplementar dhe plotësues me promovimin dhe monitorimin e zbatimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Programet e trajnimit do të kombinohen me programet e trajnimeve të cilat i zbaton IAP-ja, duke iu referuar Qëllimit strategjik 4 të kësaj Strategjie. Zbatimi i këtyre programeve të trajnimit do të bëhet në bashkëpunim të plotë me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, donatorët dhe organizatat e shoqërisë civile.

Objektivi specifik 3.4: Bashkëpunimi ndërkombëtar në ndërtimin e kapaciteteve reciproke, shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira me vendet rajonale drejt arritjes së progresit në promovimin dhe adresimin e OZhQ-së.

Në Konferencën e Dymbëdhjetë Ndërkombëtare është arritur pajtimi që Komiteti Koordinues Ndërkombëtar i Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut mbështet ndërtimin e kapaciteteve, ndarjen e përvojave dhe praktikave të mira, si dhe menaxhimin e njohurive me dhe ndërmjet IKDNj-së në lidhje me Agjendën dhe mobilizimin e burimeve për këtë qëllim. Bazuar mbi partneritetin strategjik trepalësh, UNDP-OHCHR-ICC pritet të sigurojë mbështetje për IKDNj, rrjetet rajonale dhe ICC në këtë drejtim . Përmes kësaj strategjie, IAP-ja do të jetë aktive në ndërmarrjen e aktiviteteve të duhura për të shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga ana e këtyre partnerëve ndërkombëtarë, më qëllim të promovimit dhe adresimit të OZhQ-së.

Qëllimi strategjik 3

Promovimi i Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ)

Objektivi specifik 3.1: Zhvillimi i programeve vetëdijësuese për promovimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Treguesit	Baza referente	Caku 2023	Caku 2025
1.Numri i programeve vetëdijësuese për promovimin e OZhQ-së	0	2 kumulativë	2 kumulativë
2.Numri i aktiviteteve vetëdijësuese për promovimin e OZhQ-së	3 (2020)	3 në baza vjetore	3 në baza vjetore

Objektivi specifik 3.3: Avancimi i kapaciteteve të stafit të IAP-së në promovimin e OZhQ-së, adresimin e tyre dhe ndërlidhjen e tyre me të drejtat e njeriut

1.Numri i trajnimeve të mbajtura për promovimin e OZhQ-së, adresimin tyre dhe ndërlidhjen e tyre me të drejtat e njeriut	0	3 (kumulativ)	2 kumulativë
2.Numri i stafit të trajnuar për promovimin e OZhQ-së, adresimin tyre dhe ndërlidhjen e tyre me të drejtat e njeriut	0	Gjithë stafi ligjor (kumulativ)	

Objektivi specifik 3.4: Bashkëpunimi ndërkombëtar në ndërtimin e kapaciteteve reciproke, shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira me vendet rajonale drejt arritjes së progresit në promovimin dhe adresimin e OZhQ-së

1.Numri i aktiviteteve të organizuara me partnerët ndërkombëtarë	0	2 (në baza vjetore)	2 (në baza vjetore)
--	---	---------------------	---------------------

6.4. Qëllimi strategjik 4

Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale dhe burime njerëzore të IAP-së

Objektivi specifik 4.1

Ofrimi i vazhdueshëm i mundësive për mësim dhe zhvillim profesional për stafin e IAP-së

Objektivi specifik 4.2

Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar të stafit përmes programeve të shkëmbimit

Objektivi specifik 4.3

Forcimi i kapaciteteve, përqendrimi në forcimin e administratës dhe menaxhimit të brendshëm të IAP-së

Objektivi specifik 4.1: Ofrimi i vazhdueshëm i mundësive për mësim dhe zhvillim profesional për stafin e IAP-së

Me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve të IAP-së, si pjesë e vlerësimit të nevojave për ndërtimin e kapaciteteve gjatë vitit 2019 është kryer një vlerësim i hollësishëm i nevojave për trajnim për të gjitha kategoritë e stafit në institucion. Në bazë të këtij vlerësimi është bërë edhe një plan i detajuar për trajnimin e stafit të IAP-së për periudhën e ardhme 3-vjeçare, i cili ka filluar zbatimin gjatë vitit 2020 me mbështetjen e projektit të BE-së mbështetje IAP-së. Ndër aspektet e trajnimit theks i veçantë i është kushtuar menitorimit për stafin që merret me shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut. Zhvillimi i kurrikulës së trajnimit të trajnerëve ka rëndësi të madhe, sepse do të bëjë të mundur që stafi i IAP-së të trajnohet dhe të zhvillojë trajnime të rregullta për stafin e vet, duke përfshirë edhe institucionet e tjera relevante (niveli qendror dhe lokal), me të cilin punon IAP-ja dhe adreson rekomandimet.

Trajnime për stafin profesional synohet të mbahen për aftësitë e hartimit, arsyetimit ligjor dhe analizës ligjore në formë të "trajnimit të trajnerëve". Përveç kësaj, fushat kryesore ku nevojitet do të mbahen trajnime të përgjithshme mbi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, trajnime të specializuara për hartimin e ligjeve, analizimin ligjor, përfshirë edhe aktivitetet kërkimore në internet.

Objektivi specifik 4.2: Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar të stafit përmes programeve të shkëmbimit

Trajnimet dhe seminarët do të kombinohen me programe të këmbimit të përvojave me vendet e tjera që do të përfshijë stafin profesional të lartë dhe ata të rinj, të cilët mund të kontribuojnë në rritjen e kualitetit të punës së IAP-së. Një ndër segmentet që do t'i jepet theks i veçantë është bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare, të cilat janë të përfshira në mbështetjen e zbatimit, promovimin dhe raportimin e Objektivave e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Prandaj edhe arritja e këtij objekti është i lidhur ngushtë me aktivitetet të cilat parashihen për ta arritur objektivin specifik 3.4.

Objektivi specifik 4.3: Forcimi i kapaciteteve, përqendrimi në forcimin e administratës dhe menaxhimit të brendshëm të IAP-së

Përveç stafit profesional synohet edhe ngritja e kapaciteteve për shërbimet administrative të IAP-së. Përmes kësaj synohet të zhvillohen aktivitete që kontribuojnë në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve administrative të IAP-së, bazuar në vlerësimin e tyre të thellë, veçanërisht në vlerësimin e ndikimit që kanë rregulloret e reja në shërbimet administrative dhe ndërtimi i fokusuar i kapaciteteve për stafin e shërbimeve administrative. Kapacitetet e rëndësishme administrative dhe menaxhuese lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore, planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit do të shqyrtohen dhe vlerësohen në mënyrë kritike dhe mbështeten për t'u zhvilluar edhe më tej. Bazuar në vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve administrative, korniza e tij rregullative do të përmirësohet përmes hartimit të rregulloreve, manualeve dhe udhëzimeve të reja të brendshme ose ndryshimit të atyre ekzistuese. Përveç trajnimeve synohet që administrata të mbështetet me instalimin e softuerit të ri në burimet njerëzore dhe në financa, i cili pritet të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin e punës së këtyre dy segmenteve në administratë. Pas një rishikimi funksional të strukturës organizative dhe riorganizimit të administratës së IAP-së, rishikimi i përshkrimeve të vendeve të punës është një nga hapat që pasojnë.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve dhe caqeve si në vijim:

Objektivi strategjik 4

Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale dhe i burimeve njerëzore të IAP-së

Objektivi specifik 4.1: Ofrimi i vazhdueshëm i mundësive për mësim dhe zhvillim profesional për stafin e IAP-së

Treguesit	BASELINE	TARGET 2023	TARGET 2025
1.Numri i trajnimeve të organizuara për zhvillim profesional për stafin e IAP-së	3	30 (kumulativ)	
2.Numri i stafit të trajnuar të IAP-së		Gjithë stafi i IAP-së merr pjesë së paku një herë	
3.Numri i programeve të ToT për stafin e IAP-së	0	4	
4.Numri i trajnerëve të trajnuar (certifikuar)	0	9	
5.Numri i trajnimeve të mbajtura nga trajnerët e brendshëm të IAP-së	0	2 trajnime në vit nga secili trajner	2 trajnime në vit nga secili trajner

Objektivi specifik 4.2: Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar të stafit përmes programeve të shkëmbimit

1.Numri i aktiviteteve të shkëmbimit të përvojave të IAP-së me vende e tjera	0 (2020)	Së paku 15 në vit	15 në vit
--	----------	-------------------	-----------

Objektivi specifik 4.3: Forcimi i kapaciteteve, përqendrimi në forcimin e administratës dhe menaxhimit të brendshëm të IAP-së, përfshirë përmes rishikimit funksional dhe të akteve të brendshme normative

1.Sistemi elektronik i menaxhimit të burimeve njerëzore, i ndërtuar		Sistemi funksional	
2.Sistemi i planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit, i zhvilluar		Sistemi funksional	
3.Rishikimi funksional dhe riorganizimi i IAP-së, i përfunduar		I përfunduar	

7. Monitorimi dhe raportimi për Strategjinë

Strategjia për Institucionin e Avokatit të Popullit 2021-2025 në përbërjen e saj ka planin e zbatimit, i cili mbulon periudhën 2021-2023. Plani i zbatimit përmban aktivitetet, treguesit, departamentet dhe njësitet përgjegjëse në kuadër të IAP-së për zbatim, si dhe vlerësimin e kostos financiare të zbatimit dhe burimin e tyre. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë do të bëhet nga një Strukturë koordinuese për monitorim dhe raportim të zbatimit të Strategjisë. Struktura koordinuese në formën e një grupi për monitorim të Strategjisë do të themelohet me vendim të Avokatit të Popullit dhe do të udhëhiqet nga Avokati i Popullit dhe do të përbëhet nga udhëheqësit e të gjitha departamenteve, të cilat kanë detyra në planin për zbatimin e Strategjisë. Vendimi për themelimin e grupit koordinues do ta përcaktojë qartë përbërjen e grupit, rolet dhe përgjegjësitë, kush do të jetë përgjegjës për punën e sekretarisë, etj. Raportimi i zbatimit të Strategjisë do të bëhet në bazë 3-mujore, vjetore dhe raportimi i përgjithshëm për vlerësimin e zbatimit të planit të zbatimit të Strategjisë, i cili do të bëhet gjatë vitit të tretë të zbatimit të Strategjisë.

